



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO			
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE			
REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA			
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY			
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	01	NR PROT. BR. PROT. NR. PROT.	833
NUMRI I FAQEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	30	DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:	22/12/2017
PRISHTINË / A			

Rregulloren Nr. 06/2017 për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm të ARH-së

Prishtinë, 22 Dhjetor 2017

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

KREU I

DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1.1. Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me:

1.1.1 Organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ARH-së, ndarjen nëpër njësi të brendshme administrative (këtej e tutje: struktura), udhëheqjen e tyre, fushëveprimin dhe kompetencat e tyre dhe marrëdhëniet reciproke në mes tyre.

Neni 2

Misioni dhe veprimtaria

2.1 ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Misioni i ARH-së është që të ofron shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Kompetencat dhe përgjegjësitë e ARH-së

3.1 ARH si organ rregullator i hekurudhave në Republikën e Kosovës është përgjegjës për:

3.1.1 licencim;

3.1.2 mbikëqyrjen e sigurisë hekurudhore;

3.1.3 rregullimin e tregut hekurudhor; si dhe

3.1.4 interoperabilitet.

3.2 Kompetencat dhe përgjegjësitë e ARH-së përkufizohen në:

3.2.1 zbatimin e legjislacionit dhe politikave në fushën e hekurudhave, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria apo Ministria kompetente,

3.2.2 ofrimin e këshillave dhe propozimeve për Ministrinë kompetente, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikën dhe legjislacionin nga fusha e hekurudhave;

3.2.3 Hartimin dhe miratimin e rregulloreve implementuese, në fushat për të cilat ARH është kompetente;

